

ABUZIMI SEKSUAL I FËMIJËVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT: GJENDJA, PËRGJIGJA INSTITUCIONALE DHE SFIDAT



SHKUP, 2026

MOHIMI JURIDIK:

KY PUBLIKIM ËSHTË FINANCUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN. PËRMBAJTJA E TIJ ËSHTË PËRGJIGJËSI E VETME E LUDVIG BOLTSMAN GESELSHAFT-
INSTITUTI PËR TË DREJTAT THEMELORE DHE TË NJERIUT (LBI-GMR) DHE
NUK PASQYRON DOMOSDOSHMERISHT QËNDRIMET E BASHKIMIT
EVROPIAN.

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	4
HYRJE	7
1. REZIME E SHKURTËR	10
Përfundime.....	11
Rekomandime.....	13

Lista e shkurtesave

OQ	Organizata Qytetare
GRETA	Grupi i Ekspertëve për Veprim Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (organ monitorues i pavarur i formuar sipas Konventës së Këshillit të Evropës, 2005)
ГРЕБИО	Grupi i Ekspertëve për Monitorimin e Konventës për Parandalimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (organ i pavarur i Këshillit të Evropës)
ESHS	Enti Shtetëror për Statistikë
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejta e Njeriut
NJVL	Njësitë e Vetqeverisjes Lokale
UE	Unioni Evropian
LDF	Ligji për Drejtësi për Fëmijët
BNJVL	Bashkësia e Njësive të Vetqeverisjes Lokale
EVS	Enti për Veprimtari Sociale
ISHP	Instituti për Shëndetin Publik
TIK	Teknologjitë Informatike-Komunikative
ISHP	Institucioni Shëndetësor Publik
IP QNPS	IP Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale
KP	Kodi Penal
KDF	Konventa e të Drejtave të Fëmijëve
SHMJR	Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
ONP	Organizata Ndërkombëtare e Punës
MPSDNJ	Ministria për Politik Sociale, Demografisë dhe të Rinjve
M3	Ministria e Shëndetësisë
PNV	Plani Nacional i Veprimtari
PTHP	Prokuroria Themelore Publike
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
KDTH	Karta e të Drejtave Themelore të BE-së
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
UNICEF	Fondi për Fëmijë i Orgnaizatës së Kombeve të Bashkuara
FRA	Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejta Themelore
HERA	Shoqata për Edukim dhe Kërkime Shëndetësore
HOPS	Opsione për Jetë të Shëndetshme Shkup

QZHQ	Qëllime e Zhvillimit të Qëndrueshëm
QPS	Qendra për Punë Sociale



HYRJE

Abuzimi seksual i fëmijëve përbën një nga shkeljet më të rënda të të drejtave të njeriut dhe të fëmijëve, me pasoja afatgjata mbi zhvillimin fizik, emocional dhe social të fëmijës. Pavarësisht detyrimeve të ndërmarra me marrëveshje ndërkombëtare si Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF)¹, Konventa e Lanzarote-s² dhe Konventa e Stambollit³, Maqedonia e Veriut ende përballet me dobësi serioze sistemike në mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi seksual. Nga evidenca e pamjaftueshme dhe reagimi i dobët institucional, deri te mungesa e shërbimeve të specializuara, programeve parandaluese dhe vetëdijes publike – të gjithë këta faktorë krijojnë një mjedis ku dhuna seksuale shpesh mbetet e papranuar dhe e pasanksionuar.

Parimet kryesore të KDF-së – si interesi më i mirë i fëmijës (neni 3), e drejta për jetë dhe zhvillim (neni 6) dhe e drejta për mbrojtje nga të gjitha format e abuzimit (neni 19) – vendosin themelet mbi të cilat duhet të ndërtohen politikat dhe praktikat kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve. Pavarësisht përparimeve ligjore, abuzimi seksual i fëmijëve mbetet një formë e vështirë për t'u identifikuar e dhunës, me pasoja të rënda mbi zhvillimin e fëmijëve dhe integrimin e tyre të mëvonshëm shoqëror.

Republika e Maqedonisë së Veriut vazhdon të përballet me sfida serioze të menaxhimit me abuzimet seksuale të fëmijëve.⁴ Problemi nuk është vetëm juridik, por edhe thelbësorë social dhe kulturorë.⁵ Ky lloj abuzimi shpesh mbetet nën hije-për shkak të frikës, turpit, tabuve dhe mosbesimit në institucione.⁶ Viktimat shpesh heshtin, veçanërisht kur autori është anëtarë i familjes, familjarë i afërt, mësimdhënës ose person nën kujdestari të fëmijës. Kjo heshtje vështirëson përpjekjet për identifikim të hershëm, ndërhyrje dhe mbështetje të fëmijës.përgjigja institucionale, edhe pse ekziston në letër, shpesh është e fragmatizuar, e pamjaftueshme dhe e pa harmonizuar. Qendrat për Punë Sociale, Institucionet Shëndetësore, Policia dhe Organet Gjyqësore funksionojnë pa një koordinim ndërsektorial të mjaftueshëm dhe me resurse të kufizuara. Njëkohësisht, mungojnë programe të detyrueshme edukative për njohjen e dhunës, edukime për personat profesional të cilët punojnë me fëmijë, si dhe shërbime adekuate për psikologji, mbështetje juridike dhe sociale të përshtatura me nevojat e viktimave.

¹ Kombet e Bashkuara, Konvencija për të drejtat e Njeriut, e qasur në:

<https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-rights-child>

² Këshilli i Evropës, Konventa për Mbrojtjen e Fëmijëve nga eksploatimi dhe keqpërdorimi seksual-Konventa e Lanzarote-s,2007, e qasur në: <https://www.coe.int/en/web/children/lanzarote-convention>

³ Këshilli i Evropës, Konventa për Prandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje-Konventa e Stambollit, 2011, e qasur në: <https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention>

⁴ UNICEF: Fëmijët përbëjnë70% nga të gjithë viktimat e identifikaura të trafikimit me qenie Njerzore në republikën e Maqedonisë së Veriut, 30 korrik 2024.

⁵ Rrjeti Nacional Kundër Dhunës ndaj Grave dheDhunës në Familje, janar 2026, Dhuna në Maqedoni është problem sitematik. (<https://trn.mk/nasilstvo-vrz-zeni-januari-2026-sistemeski-problem/>)

⁶ Vecer, "Çdo tre ditë abuzues seksual sulmojnë fëmijë", 23 janarë 2026. <https://www.vecer.press/porazitelni-podatoczi-za-minatata-godina-na-sekoi-tri-dena-nasilniczi-seksualno-napagaat-decza/>

Në vitin 2012, Avokati i Popullit në rilon e tij si institucion ancional për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve shpalli Raport të veçantë,⁷ me rekomandime të qarta për përmirësimin e situatës së fëmijëve viktime të abuzimeve seksuale dhe shfrytëzimeve seksuale. Gjithsesi, këto rekomandime nuk u zbatuan në tërësi, që tregon në implementim të kufizuar të zgjedhjeve të propozuara sistematike. Në periudhën nga viti 2020-2024, konteksti mbetet paralajmërues: - ndërgjegjësim publik i pamjaftueshëm, besim i kufizuar ndaj institucioneve, regjistrim jo i plotë dhe mbështetje e pamjaftueshme për viktimat.⁸

Në Pasqyrimet përfundimtare të vitit 2022,⁹ Komiteti për të Drejtat e Fëmijës përsëriti përpjekjet e Maqedonisë së Veriut për përmirësimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, duke përfshirë reformat ligjore që kriminalizojnë dhunën ndaj fëmijëve, miratimin e **Strategjisë Nacionale (2020–2025) dhe Planit të Veprimit (2020–2022) për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna**.¹⁰ Komiteti përsëriti gjithashtu **ratifikimin e Konventës së Lanzarote-s dhe Konventës së Stambollit**, si mekanizma ndërkombëtarë për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual.

Për më tepër, Komiteti në vërejtjet e veta përfundimtare dha rekomandime të qarta për Maqedoninë e Veriut lidhur me: forcimin e mekanizmave për identifikim, ndërhyrje dhe rehabilitim; rritjen e transparencës në reagimin institucional dhe zhvillimin e strategjive nacionale për parandalimin e dhunës seksuale ndaj fëmijëve.

Komiteti shprehu shqetësim serioz për zbatimin e kufizuar të ligjeve dhe politikave dhe evidentoi disa mangësi sistematike, ndër të cilat:

- mungesë e burimeve financiare dhe njerëzore për zbatimin e strategjive dhe planeve nacionale;
- mungesë e kuadrit profesional dhe qasje e pamjaftueshme në shërbime për fëmijët në rrezik nga dhuna;
- koordinim i dobët dhe protokolle të paqarta mes institucioneve në nivel lokal;
- raportim i pamjaftueshëm dhe informacione të kufizuara për hetimin dhe ndjekjen e rasteve të abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve;
- mungesë e terapisë së specializuar dhe rehabilitimit të përshtatur për nevojat e fëmijëve;

⁷ Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, raport nga hulumtimi i realizuar për dukurinë e abuzimit seksual dhe eksploatimit seksual të fëmijëve, shatatorë 2012, <https://ombudsman.mk/%D0%9F%D0%BE%D1%87%D0%B5%D1%82%D0%BD%D0%B0/%D0%9F%D0%A0%D0%9E%D0%9C%D0%9E%D0%A2%D0%98%D0%92%D0%95%D0%9D%D0%9C%D0%90%D0%A2%D0%95%D0%A0%D0%98%D0%88%D0%90%D0%9B/%D0%91%D1%80%D0%BE%D1%88%D1%83%D1%80%D0%B8%D0%B8%D0%BF%D1%83%D0%B1%D0%BB%D0%B8%D0%BA%D0%B0%D1%86%D0%B8%D0%B8.aspx>

⁸ Policia e Ohrid: Masë e caktuar paraburgimi dhe raportime për të miturit nga Velesi të dyshuar për përdhunim dhe zhvatje ndaj fëmijës së mitur, 26 nëntorë 2025, e qasur në: <https://mvr.gov.mk/mk-MK/odnosi-so-javnost/novosti/odredena-merka-pritvor-i-podneseni-prijavi-za-maloletnici-od-oxrid-za-storeni-krivnici-dela-siluvanje-i-ucena-vrz-maloletnicka>

⁹ Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, viti 2022, Pasqyrimet përfundimtare për raportin e kombinuar 3-6 –shtë, CRC/C/MKD/CO/3-6 20 tetorë 2022

¹⁰ https://www.google.com/url?sa=t&source=web&rct=j&opi=89978449&url=https://portal.mdt.gov.mk/post-body-files/nacionalni-strategii-file-w9eY.doc&ved=2ahUKewinIOSK_bWTaxVbQvEDHWVMEGcQFnoECCEQAQ&usg=AOvVaw1ulFeQAZB8zW7YRQt-CnzV

- mungesë e edukimit dhe mbështetjes për prindërit;
- nivel i ulët i vetëdijes publike dhe tolerancës ndaj dhunës, të nxitur nga stereotipe tradicionale gjinore;
- mungesë e përpjekjeve sistematike për t'u përballur me dhunën online, dhunën mes bashkëmoshatarëve dhe diskriminimin ndaj grupeve të cenueshme, përfshirë të rinjtë LGBT, fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët nga komuniteti rom;
- mungesë e hulumtimeve sistematike dhe të dhënave statistikore për përhapjen e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve.

Në drejtim të përmirësimit të gjendjes, Komiteti i rekomandoi shtetit që të:

1. Sigurojë **zbatimin e plotë** të Strategjisë Nacionale (2020–2025) dhe Planit të Veprimit (2020–2022) për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna, duke garantuar burime të përshtatshme financiare dhe njerëzore.
2. **Forcojë Qendrat për Punë Sociale** duke rritur numrin e punonjësve socialë dhe duke siguruar disponueshmërinë e tyre 24/7.
3. Vendosë një **sistem të detyrueshëm për raportim dhe ndërhyrje multi-institucionale** në rastet e dhunës, përfshirë abuzimin seksual në familje dhe në mjedisin online.
4. Sigurojë **procedura të përshtatura për fëmijët** – intervistat me viktimat dhe dëshmitarët të kryhen nga persona të trajnuar në një mjedis të sigurt, duke minimizuar rrezikun e viktimizimit sekondar.
5. Vendos **regjistrimet audio-vizuale të dëshmisë së fëmijës** si procedurë standarde provash.
6. Sigurojë **terapi dhe rehabilitim të përshtatur për fëmijën**, si dhe mbështetje për familjet e viktimave.
7. Zbatojë **fushata edukative dhe publike** për rritjen e vetëdijes mbi dhunën, abuzimin seksual, shfrytëzimin dhe rreziqet online.
8. Kryejë **hulumtime gjithëpërfshirëse** mbi dhunën ndaj fëmijëve, duke mbledhur të dhëna për abuzimin seksual, shfrytëzimin, hetimet dhe sanksionet ndaj autorëve.

Kjo analizë ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë të plotë dhe objektive mbi gjendjen e abuzimit seksual të fëmijëve në Maqedoninë e Veriut gjatë periudhës nga viti 2020–2025. Analiza do të përfshijë një shqyrtim të kuadrit ligjor ndërkombëtar dhe kombëtar, strukturës institucionale dhe praktikës, të dhënave të disponueshme dhe sfidave kryesore në luftën kundër kësaj lloji dhune. Me fokus të veçantë tek grupet e cenueshme, analiza do të identifikojë dobësitë sistematike dhe do të ofrojë rekomandime konkrete, të zbatueshme dhe të qëndrueshme për përmirësimin e mbrojtjes së fëmijëve. Theksi do të vihet mbi nevojën për koordinim ndërsektorial, edukim të vazhdueshëm, përmirësim të qasjes në mbështetje dhe rritje të vetëdijes publike – të gjitha këto si parakushte për një shoqëri ku çdo fëmijë mund të rritet dhe të zhvillohet pa frikë nga dhuna, abuzimi dhe neglizhenca.

1. REZIME E SHKURTËR

Abuzimi seksual i fëmijëve përfaqëson një problem serioz, kompleks dhe afatgjatë shoqëror, i cili lë pasojë të përhershme psikologjike, fizike dhe sociale mbi fëmijët-viktima, si dhe mbi familjet dhe komunitetin më të gjerë. Analiza e gjendjes në Maqedoninë e Veriut për periudhën 2020–2024 tregon se, pavarësisht ekzistencës së një kuadri ligjor dhe strategjik formal, sistemi i mbrojtjes së fëmijëve-viktima nuk ofron mbështetje të qëndrueshme, të menjëhershme dhe të përshtatur, duke respektuar parimin e interesit më të mirë të fëmijës.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Punëve të Brendshme,¹¹ në periudhën 2020–2024 janë evidentuar 508 raste të abuzimit seksual të fëmijëve, gjë që tregon për një prani të vazhdueshme dhe alarmante të këtyre veprave penale. Pjesa më e madhe e viktimave janë fëmijë të moshës 11–15 vjeç, ku vajzat janë më të prekura (90%). Njëkohësisht, të dhënat tregojnë për një përfaqësim të lartë të fëmijëve romë mes viktimave, duke theksuar cenueshmërinë e tyre strukturore, përjashtimin social dhe qasjen e kufizuar në mekanizma të përshtatshëm dhe të menjëhershëm për mbrojtje.

Analiza bazohet në një metodologji të kombinuar, e cila përfshin analizën e të dhënave zyrtare statistikore, përgjigjet nga institucionet relevante, si dhe shqyrtimin e kuadrit ligjor dhe strategjik ekzistues. Ky qasje mundëson vlerësimin jo vetëm të përmasës së fenomenit, por edhe të efektivitetit të reagimit institucional dhe funksionimit praktik të sistemit.

Gjetjet tregojnë dobësi serioze dhe të përsëritura sistemike në trajtimin e fëmijëve-viktima të abuzimit seksual. Fëmijët-viktima shpesh i nënshtrohen dëgjimeve të shumta në institucione të ndryshme, në kushte që nuk janë të përshtatura për moshën dhe gjendjen e tyre psikologjike. Mungesa e hapësirave të specializuara dhe miqësore për fëmijët, numri i kufizuar i stafit të trajnuar profesionalisht dhe koordinimi joefikas ndërsektorial rrisin ndjeshëm rrezikun e viktimizimit sekondar.

Përveç kësaj, mbështetja shëndetësore, psikosociale dhe psikologjike shpesh reduktohet në ndërhyrje të menjëhershme, pa siguruar kujdes të vazhdueshëm dhe afatgjatë, gjë që vë në pikëpyetje mundësinë e rehabilitimit dhe shërimit të plotë të fëmijës. Mbështetja për familjet, edhe pse thelbësore për procesin e rikuperimit, mbetet e fragmentuar dhe jo mjaftueshëm e institucionalizuar.

Në përgjithësi, analiza tregon se tek një numër i konsiderueshëm rastesh nuk zbatohet parimi i interesit më të mirë të fëmijës, i përcaktuar nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës. Ekzistenca formale e dispozitave ligjore, protokolleve dhe planeve të veprimit nuk reflektohet në praktikë të qëndrueshme dhe cilësore, gjë që rezulton në mbrojtje të pabarabartë të fëmijëve dhe trajtim të ndryshëm në varësi të institucionit ose vendbanimit.

Këto gjendje theksojnë nevojën për një reformë thelbësore, jo deklarative, të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve-viktima të abuzimit seksual, përmes vendosjes së një qasjeje funksionale multidisiplinare, forcimit të përgjegjësisë institucionale dhe sigurimit të zgjidhjeve sistemike që e vendosin fëmijën në qendër të veprimit, e jo në periferi të tij.

¹¹ Ministria e Punëve të Brendshme, përgjigje ndaj kërkesës për të dhënat mbi regjistrimin e rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve për periudhën 2020-2024, paraqitur në maj të vitit 2025, e marrë në qershorë të vitit 2025

Përfundime

1. Abuzimi seksual i fëmijëve përfaqëson problem të vazhdueshëm dhe sistemik në Maqedoninë e Veriut, siç e konfirmojnë të dhënat e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në periudhën 2020–2024 janë regjistruar gjithsej 508 raste të abuzimit seksual të fëmijëve. Këto shifra tregojnë një fenomen të vazhdueshëm që kërkon përgjigje të koordinuar, institucionale dhe afatgjatë, veçanërisht shqetësues është fakti që pjesa më e madhe e rasteve lidhen me vepra penale të rënda, si përdhunimi i fëmijës nën moshën 15 vjeç (186 raste) dhe sulmi seksual dhe përdhunimi (99 raste), gjë që tregon për mangësi serioze në parandalim dhe në identifikimin e hershëm të rreziqeve. Gjatë vitit 2025 në vend janë regjistruar 96 fëmijë viktime të veprave penale kundër lirisë seksuale dhe moralit seksual, prej të cilëve 88 vajza dhe 8 djem. Vepra më e shpeshtë e regjistruar ka qenë përdhunimi i fëmijës nën 15 vjeç, me 48 viktime. Pas çdo rasti qëndron një fëmijë që ka kaluar nëpër një traumë të rëndë – por, për fat të keq, shpesh edhe nëpër një sistem që nuk arrin gjithmonë ta mbrojë mjaftueshëm.¹²
2. Në periudhën 2020–2024, adoleshentët përfaqësojnë grupin më të cenueshëm të moshës, ku mbi 57% e viktimave janë të moshës 11–15 vjeç (153 fëmijë të moshës 11–13 vjeç dhe 139 fëmijë të moshës 14–15 vjeç). Kjo strukturë moshe tregon ekspozim më të madh ndaj rreziqeve të lidhura me komunikimin online, rrjetet sociale, edukimin seksual të kufizuar dhe mbikëqyrjen e pamjaftueshme prindërore dhe institucionale. Njëkohësisht, rastet e regjistruara tek fëmijët nën 10 vjeç, përfshirë edhe një fëmijë nën moshën 3 vjeç, përbëjnë një tregues alarmant për mangësi serioze në mbrojtjen e fëmijëve më të vegjël dhe kategorisë më të cenueshme.
3. Ekziston një pabarazi gjinore mes viktimave: 455 nga viktimat e regjistruara (89,6%) janë vajza, ndërsa 53 (10,4%) janë djem.¹³ Edhe pse vajzat janë më të prekura, të dhënat tregojnë se abuzimi seksual prek edhe djemtë, ku ka dyshime të bazuara se numri real i viktimave meshkuj është më i madh për shkak të stigmatizimit, turpfit dhe stereotipeve shoqërore që e vështirësojnë raportimin. Kjo nënvizon nevojën për mekanizma të ndjeshëm ndaj gjinisë për identifikimin, mbështetjen dhe mbrojtjen e të gjithë fëmijëve-viktima.
4. Dëgjimi i përsëritur i fëmijëve-viktima përfaqëson problem serioz strukturor dhe formë të viktimizimit sekondar. Pavarësisht nenit 170 paragrafi (4) dhe nenit 173 paragrafi (6) të Ligjit për Drejtësi për Fëmijët, të cilat parashikojnë që dëshmia e fëmijës duhet të regjistrohet dhe të përdoret në procedurat e mëvonshme, në praktikë fëmijët shpesh dëgjohen disa herë nga institucione të ndryshme (Policia, QPS, Prokuroria, Gjykata), pa koordinim dhe pa përdorimin e dëshmisë tashmë të dhënë. Kjo bie ndesh drejtpërdrejt me parimin e interesit më të mirë të fëmijës dhe çon në përjetimin e përsëritur të traumës.
5. Mungesa e hapësirave të specializuara dhe kushteve të përshtatura për dëgjimin e fëmijëve minon besimin e tyre tek institucionet dhe rrit dëmin

¹² <https://www.vecer.press/porazitelni-podatoczi-za-minatata-godina-na-sekoi-tri-dena-nasilniczi-seksualno-napagaat-decza/>

¹³ Minsitria e Punëve të Brendshme, përgjigje ndaj kërkesës për të dhënat mbi regjistrimin e rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve për periudhën 2020-2024, paraqitur në maj të vitit 2025, e marrë në qershorë të vitit 2025

psikologjik. Pavarësisht garancive ligjore (neni 171 i Ligjit për Drejtësi për Fëmijët) për përdorimin e regjistrimeve video dhe audio, kufizimin e numrit të dëgjimeve, mbrojtjen e privatësisë dhe ndalimin e ballafaqimit me të akuzuarin, këto masa shpesh nuk zbatohen për shkak të mbështetjes jo të plotë infrastrukture, numrit të pamjaftueshëm të hapësirave të specializuara dhe mungesës së stafit profesional. Sipas të dhënave të disponueshme nga hulumtimi i kryer në vitin 2022, në Maqedoninë e Veriut ekzistojnë vetëm tetë hapësira të specializuara për dëgjimin e fëmijëve dhe vetëm shtatë për qind e fëmijëve të thirrur në stacion policor e kanë pasur intervistën në hapësirë të përshtatur për fëmijë, gjë që tregon për mbështetje të kufizuar infrastrukture për zbatimin e procedurave të përshtatura për fëmijët në sistemin e drejtësisë.

6. Mungesa e specializimit dhe trajnimit të profesionistëve kufizon mbrojtjen efektive të fëmijëve. Mungojnë trajnimet e vazhdueshme për qasje të informuar mbi traumën dhe komunikim me fëmijët-viktima të abuzimit seksual.
7. Mbështetja psikosociale mbetet e kufizuar dhe afatshkurtër, kryesisht e fokusuar gjatë procedurës dhe ndonjëherë pak pas saj, pa siguruar rehabilitim, rikuperim dhe riintegrim social afatgjatë. Kjo e redukton ndjeshëm mundësinë e shërimit të plotë të fëmijës dhe cenon detyrimin ligjor të shtetit për të garantuar zhvillimin e shëndetshëm të viktimës.
8. Koordinimi i pamjaftueshëm ndërsektorial mes institucioneve kyçe rezulton në procedura të paunifikuara, praktika të ndryshme dhe mbrojtje të pabarabartë të fëmijëve-viktima. Kjo është veçanërisht problematike duke pasur parasysh numrin e madh të rasteve, seriozitetin e veprave penale dhe rrezikun e viktimizimit sekondar.
9. Fëmijët romë janë veçanërisht të cenueshëm, me 145 viktima (28%) që i përkasin kësaj përfaqësie, gjë që tregon efektin kumulativ të varfërisë, përjashtimit social, besimit të ulët tek institucionet dhe qasjes së kufizuar në shërbime. Mungesa e programeve të synuara dhe të ndjeshme ndaj kulturës për parandalim dhe mbështetje e thëllon më tej pabarazinë dhe rrezikun e abuzimit.
10. Pavarësisht ekzistencës së kuadrit ligjor dhe strategjik, garancitë formale për masa të veçanta të mbrojtjes procedurale nuk zbatohen në mënyrë të qëndrueshme, gjë që tregon për një hendek të rëndësishëm mes rregullimit normativ dhe zbatimit praktik, duke reduktuar efektivitetin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve-viktima të abuzimit seksual.

Rekomandime

Me qëllim të tejkalimit të dobësive sistematike të konstatuara dhe sigurimin e veprimit në përputhje me parimin për interesin më të mirë të fëmijës, rekomandohet:

➤ Zbatimi i qëndrueshëm i masave ekzistuese të veçanta për mbrojtje procedurale

Fëmija të dëgjohej vetëm një herë, duke siguruar regjistrim video/audio, privatësi dhe ndalim të ballafaqimit me të akuzuarin. Kështu reduktohet rreziku i viktimizimit sekondar dhe përforcohet respektimi i të drejtës së fëmijës sipas Ligjit për Drejtësi për Fëmijët (nenet 170–174).

➤ Pajisja e hapësirave të specializuara, të përshtatura për fëmijë

Të sigurohen hapësira miqësore dhe private për dëgjimin e fëmijëve-viktima në Polici, PTHP, Gjykata dhe QPS, të disponueshme në gjithë vendin, të pajisura me sisteme moderne video dhe audio dhe të përshtatura për moshën dhe nevojat psikologjike të fëmijëve. Kjo rrit besimin e fëmijës tek institucionet dhe ul stresin e dëmit psikologjik.

➤ Trajnim i vazhdueshëm dhe i specializuar i profesionistëve

Të futen trajnime të rregullta, të vazhdueshme dhe të detyrueshme për gjyqtarë, prokurorë, polic, punëtorë social dhe profesionistë të tjerë që kanë kontakt me fëmijët, për një qasje të përshtatur të bazuar në kuptimin e traumës dhe komunikimin me fëmijët-viktima të abuzimit seksual. Trajnimet duhet të mundësojnë identifikimin dhe trajtimin efektiv të të gjithë fëmijëve-viktima, pa dallim gjinie, moshe, përkatësie etnike apo status social.

➤ Praktika të individualizuara për mbrojtjen e grupeve të cënueshme të fëmijëve

Të vendosen praktika sistematike dhe të individualizuara në raportim, dëgjim dhe mbështetje psikosociale, të përshtatura për nevojat e fëmijës, me fokus të veçantë tek grupet e cënueshme (përfshirë fëmijët romë dhe fëmijët nën 10 vjeç) dhe mbrojtjen nga stereotipet që mund të kufizojnë raportimin e abuzimit.

➤ Mbështetje psikosociale dhe rehabilitim afatgjatë

Të krijohet rrjet nacional për mbështetje psikosociale që ofron terapi, këshillim, mentorim dhe riintegrim social për të gjitha viktimat e abuzimit seksual. Rrjeti duhet të përfshijë: Qendra të Specializuara për Mbështetje Psikosociale, punëtor social dhe mentorë të trajnuar, Institucione Shëndetësore dhe Arsimore, si dhe mbështetje nga Organizatat Qytetare kur është e nevojshme. Mbështetja duhet të jetë e vazhdueshme dhe afatgjatë, e disponueshme në gjithë vendin, veçanërisht për grupet e cënueshme, me qëllim rikuperimin e plotë të fëmijës dhe mbrojtjen e të drejtës së tij për zhvillim të shëndetshëm.

➤ **Koordinim ndërsektorial dhe harmonizim i procedurave**

Të formohen ekipe multidisiplinare dhe multisektoriale si dhe standarde kombëtare për veprim, dëgjim dhe mbështetje të fëmijëve-viktima, të cilat janë të detyrueshme për zbatim dhe për sigurimin e reagimeve të shpejta, efikase dhe të harmonizuara, me qëllim reduktimin e rrezikut të viktimizimit sekondar.

➤ **Programe të synuara për grupet më të cënueshme**

Të zhvillohen programe të institucionalizuara, të mbështetura nga shteti dhe të përshtatura kulturore për parandalim dhe mbështetje për grupet më të cënueshme të fëmijëve, përfshirë fëmijët romë dhe fëmijët nën 10 vjeç, me qasje të lehtë dhe të menjëhershme ndaj shërbimeve institucionale dhe mbrojtje afatgjatë. Këto programe do të reduktojnë rreziqet strukturore dhe do të mundësojnë mundësi të barabarta për mbrojtjen e të gjitha grupeve.

➤ **Vendosja e modelit “Barnahus” (Barnahus)**

Të futet modeli “Barnahus”, ku fëmija dëgjohe vetëm një herë, në mjedis të sigurt, miqësor dhe të përshtatur, nga ekip multidisiplinar i përbërë nga punonjës social, psikolog, përfaqësues ligjor dhe profesionistë shëndetësorë të specializuar. Modeli siguron:

- Mbështetje ligjore për fëmijën dhe familjen;
- Mbështetje psikosociale dhe vlerësim të gjendjes emocionale dhe nevojave të fëmijës;
- Ekzaminime mjekësore dhe vlerësim shëndetësor, përfshirë dokumentacion forenzik dhe kujdes shëndetësor;
- Koordinim të plotë mes institucioneve, për të shmangur dëgjimin e përsëritur dhe viktimizimin sekondar.

Modeli Barnahus forcon bashkëpunimin ndërsektorial, siguron qasje të integruar dhe respekton parimin e interesit më të mirë të fëmijës, duke mundësuar mbrojtje efektive dhe reduktim të traumës.

➤ **Monitorimi dhe vlerësimi i kornizës ligjore dhe strategjike**

Të vendoset një sistem për mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë, me qëllim monitorim të rregullt, gjithëpërfshirës dhe transparent të numrit, moshës dhe gjinisë së viktimave, si dhe efektivitetit të masave për mbrojtje procedurale dhe mbështetje psikosociale, me raporte dhe rekomandime vjetore për përmirësim. Kjo do të reduktojë hendekun mes kornizës ligjore dhe zbatimit të saj praktik dhe do të forcojë efektivitetin e sistemit.

➤ **Informim publik dhe edukim i komunitetit**

Të zbatohen fushata dhe programe të rregullta për edukim publik dhe parandalim të abuzimit seksual të fëmijëve, të cilat marrin parasysh grupet e cënueshme dhe janë të ndjeshme ndaj dallimeve gjinore, etnike dhe të moshës, me qëllim rritjen e

vetëdijes dhe nxitjen e raportimit të të gjitha rasteve të abuzimit. Kjo do të forcojë mbrojtjen e fëmijëve dhe besimin në institucione.

➤ **Parandalim dhe edukim në shkolla**

Të futen programe të detyrueshme dhe të rregullta për parandalim dhe edukim në të gjitha shkollat, të integruara në mësimin e rregullt, të cilat përfshijnë biseda, punëtori interaktive dhe aktivitete për rritjen e vetëdijes tek fëmijët mbi rreziqet e abuzimit seksual, përdorimin e sigurt të internetit dhe rrjeteve sociale, si dhe të drejtat e fëmijës. Programet duhet të jenë të përshtatura për moshën dhe aftësitë zhvillimore të fëmijëve dhe të përfshijnë vlerësim të vazhdueshëm për efektivitetin, me qëllim që fëmijët të fitojnë njohuri, të zhvillojnë aftësi dhe besim për të raportuar parregullsitë ose rreziqet e abuzimit, ndërkohë që të zhvillohet ndjeshmëria dhe përgjegjësia në të gjithë komunitetin shkollor.
